



## AKT - THEMELIMI

KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### " A D A - C O " SH.P.K

Sot më datë 10.01.2001 , unë i nënshkruari Perparim Beqir LATIFLLARI ,lindur më 21.3.1962, banues ne Lagjen nr.1 banesa nr 10 Rruga e Drilonit te qytetit Pogradec ,me cilësinë e Ortakut të vetëm po krijoj Shoqërinë " A D A - C O " SH.P.K të cilën unë e përfaqësoj mbështetur ne dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

### H Y R J E

Kuptimi i këtij Akt - Themelimi është krijimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " A D A - C O " SH.P.K me seli ne Lagjen nr.1 banesa nr 10 Rruga e Drilonit, dhe me shtrirje në të gjithë rrethin e Pogradecit dhe me të drejtën e zgjerimit të mëtejshëm në degë e filiale të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë .

Shoqëria gjithë veprimtarinë e saj do ta realizojë në pajtim të plotë me këtë Akt - Themelim si dhe dispozitat e Statutit të Shoqërisë të mbështetura në lesgjislacionin aktual.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria tregëtare" A D A - C O " SH.P.K do të zhvillojë veprimtarinë e saj private në fushen e shërbimit tregëtar me kete objekt :

*"Tregëtimin me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore , fruta-perime , materjale ndertimi ,pjesë nderrimi per automjete , goma,tapiceri e veshje sedilje,paisje elektrik-mekanike,tekstile artistike e kanceleri, Eksport - import. Trasport mallra e pasagjere"*

### KOHE ZGJATJA

Shoqëria e ka emrin e saj " A D A - C O " SH.P.K dhe gëzon të drejtën e fillimit të veprimtarisë së saj në përputhje të plotë me objektin e mësipërm që nga momenti i miratimit të vendimit të Gjykatës të rrethit Tirane si Person Juridik, me kohezgjatje mbi 10 vjet.

### KAPITALI I SHOQERISE

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së saj,Shoqëria " A D A - C O " SH.P.K ka një kapital themeltar 100 (njqind) mijë lekë që përbën burimin fillestar për krijimin e fondit rezervë,të fondit të veçantë e të mjeteve të xhiros.